



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



I	Data	06.02/20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01 Nr. 060/01-2480/20				

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së I-r (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 31 Janar 2020.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e I-r (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 31 Janar 2020, dhe atë:

1. Vendimi për Emërtimin dhe Riemërtimin e rrugëve lokale/ Lënda: 01Nr. 104/02-1699/20;
2. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020 / Lënda: 060/01-1918/20;
3. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Kaçanikut për periudhën: Janar-Shtator 2019/ Lënda: 01Nr.60/01-2076/20;
4. Vendimi për Aprovimin e Plani të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020 / Lënda: 01Nr.60/01-2249/20;
5. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01 Nr. 60/01-36408/19 ;
6. Vendimi për miratimin e Nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomuna; me Komunën e Shterpcës/ Lënda: 01Nr.104/02-2476/20;

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-1699/20
Kaçanik, 31.01.2020

Në mbështetje të nenit 17 pika (o) dhe 40 pika (i) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 24 i Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, nenit 15 pika (i) e Rregullores 01.Nr 7864/08 e Punës së Kuvendit Komunal të Kaçanikut, të Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2012 për Caktimin e Emërimit dhe Numërimit të Adresave për Zonat e Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira, të Propozim Vendimit 01. Nr. 464/02-1699/20 prej datës 16.01.2020 të Komisionit për emërimin, riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale të Komunës së Kaçanikut, të Shkresa referuese e Agjencisë Kadastrale të datës 16.01.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 31 Janar 2020, mori këtë:

V E N D I M

PËR EMËRTIMIN DHE RIEMËRTIMIN E RRUGËVE LOKALE PAS SHQYRTIMIT TË ANKESAVE, KËRKESAVE DHE PROPOZIMEVE NGA QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Neni 1

Me këtë Vendim, pas shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut, të cilat datojnë që nga viti 2015 e deri më tani, emërohen dhe riemërohen rrugët lokale të cilat ishin të pa emërtuara, kontestuar dhe papranuara, si dhe të cilat nuk i plotësonin kushtet për emërtim.

Neni 2

Në fshatin Begracë, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

- 2.1 Rr. "Shefki Gashi" të zëvendësohet në rr "Rilindja";
- 2.2 Rr. "Salla Luzha" të përmirësohet në rr. "Sallah Luzha"
- 2.3 Rr. "Hamdi Trena" të zhvendoset;
- 2.4 Rr. "Qirupi" të përmirësohet në rr. "Qurupaj";
- 2.5 Rr. "Raif Luzha" të zhvendoset;
- 2.6 Emërtim i ri "Ahmat Luzha";
- 2.7 Rr. "Përparim Luzha" të zhvendoset;
- 2.8 Rr. "Adriatiku" të zëvendësohet me rr. "Hisen Gashi";
- 2.9 Rr. "Toska" të zhvendoset;

- 2.10 Rr. "Mehmet Begraca" të zhvendoset në rr. "Toska";
- 2.11 Rr. "Mehmet Begraca" riemërohet në rr. "Latif Luzha";
- 2.12 Rr. "Rifat Gashi" të zëvendësohet në rr. "Fejza";
- 2.13 Rr. "Kaçakët" të zëvendësohet me rr. "Fejza".

Neni 3

Në fshatrat Vatë, Rekë dhe Dubravë, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

- 3.1 Rr. "Eksodi 99" të riemërohet rr. "Bajram Curri";
- 3.2 Emërtim i ri rr. "Ilir Caka";
- 3.3 Rr. "Arbëreshët" të riemërohet rr. "Riza Neziraj"
- 3.4 Rr. "Hamit Neziraj" të riemërohet rr. "13 Luftëtarët";
- 3.5 Rr. "Havzi Imishti" të riemërohet rr. "Rrafshi i Përronit";
- 3.6 Rr. "Rrënza e Sharrit" të vazhdohet deri në përfundim të rrugës së lagjes Xhini;
- 3.7 Emërtim i ri rr. "Milazim Krasniqi";
- 3.8 Emërtim i ri rr. "Kodra e Dushkut"
- 3.9 Emërtim i ri rr. "Mërgimtarët";
- 3.10 Emërtim i ri rr. "Nënë Tereza";
- 3.11 Emërtim i ri rr. "Shefki Vishi";
- 3.12 Segmenti rrugor i Rr. "UÇK" të riemërohet rr. "Sadik Guri" nga degëzimi Rr. "Feriz Guri" deri te "Beteja e 25 Majit";
- 3.13 Rr. "Sadik Guri" të zëvendësohet në Rr. "Malsia;
- 3.14 Emërtim i ri rr. "Fetije Qorri";
- 3.15 Rr. "Bekim Berisha" të riemërohet në rr. "Riza Kasa";
- 3.16 Emërtim i ri rr. "Tahir Baftiu";
- 3.17 Emërtim i ri rr. "Sportisti";
- 3.18 Emërtim i ri rr. "Shullani";
- 3.19 Emërtim i ri rr. "Rezistenca";
- 3.20 Emërtim i ri rr. "Tahir Sinani";
- 3.21 Emërtim i ri rr. "Mirëdita";
- 3.22 Emërtim i ri rr. "Vatra Shqiptare";
- 3.23 Emërtim i ri rr. "Qëndresa";

Neni 4

Në zonën urbane Kaçanik dhe Lagjja Bela, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

- 4.1 Rr. "Hasan Prishtina" dhe rr. "Nexhmush Fera" zëvendësohen me njëra-tjetrën;

4.2 Rr. "Martirët e Lirisë" të riemërohet rr. "Baki Bela".

4.3 Rr. "Dëshmorët e Kombit" segmenti rrugor Dushkajë-Stagovë;

4.4 Rr. "Izahir Troni" segmenti rrugor Kovaçec-Nikaj.

Neni 5

Në fshatin Bajnicë, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

5.1 Rr. "Cen Loku" riemërohet në Rr. "Razim Salihu";

5.2 Emërtim i ri rr. "Qamil Rexhepi";

5.3 Emërtim i ri rr. "Lagjja Fazliu".

Neni 6

Në fshatin Kaçanik i Vjetër, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

6.1 Emërtim i ri rr. "Cen Loku";

6.2 Emërtim i ri rr. "Neshat Rexha";

6.3 Emërtim i ri "Brahim Prushi".

Neni 7

Në fshatin Gajre dhe Ivajë, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

7.1 Rr. "Avdi Fejzullah Çallaku" riemërohet rr. "28 Shkurti";

7.2 Emërtim i ri rr. "Blinaja";

7.3 Rr. "Neshat Rexha" riemërohet rr. "Dëshmorët e Trogirit";

Neni 8

Në fshatin Stagovë, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

8.1 Rr. "Hamdi Hysa" të zhvendoset;

8.2 Rr. "TMK-së" të vazhdohet deri te rr. "Rexhep Teneqja"

Neni 9

Në fshatin Soponicë, emërohen dhe riemërohen rrugët si në vijim:

10.1 Rr. "Sharri" bashkohet me rr. "Leka i Madh" emërtohet rr. "Sharri";

10.2 Degëzimi i rr. "Sharri" të riemërohet rr. "Remzi Lama".

Neni 10

Në fshatin Sllatinë, emërohen rrugët si në vijim:

11.1 Emërtim i ri rr. "Halilaj";

11.2 Emërtim i ri rr. "Doktor Veseli";

Neni 11

Në fshatin Gllloboçicë, emërohet rruga si në vijim:

11.1 Emërtim i ri rr. "Gajur Leka".

Neni 12

12.1. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është: Raporti i Komisionit 01Nr. 104/02-36175/19 i datës 11.11.2019; Shkresa sqaruese e këtij komisioni komisioni drejtuar MMPH dhe MAPL, Shkresa referuese e Agjencisë Kadastrale(bashkangjitur këtij vendimi).

12.2. Rrugët të tjera të cilat kanë mbetur pa emërtuar, do të vazhdoj punën me emërtimin e tyre Komisioni i formuar me Vendim të Kuvendit 01. Nr. 104/02 5069/18 të datës 28/02/2018- për emërimin, riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale të Komunës së Kaçanikut, deri në përfundimin e tërë procesit.

Neni 13

Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes të Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës që të bëjë shënimin në sistem dhe në teren të rrugëve në bazë të këtij Vendimi.

Neni 14

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit, dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 15

15.1. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, ndryshohet dhe plotësohen: Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 16-17460/2012 i datës 27.09.2012 dhe Vendimi i Kuvendit të Komunës 01.Nr. 16-1236/2014 i datës 27.06.2014.

15.2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-36179/19 i datës 29 Nëntor 2019 për shkak të disa ndryshimeve që ka pësuar vendimi.

Neni 16

Me këtë Vendim do të njoftohen: Institucionet relevante qendrore dhe lokale, Kryetari i Komunës, Drejtoritë Komunale dhe nëpërmjet tyre njoftohen organet tjera relevante, Administratorët e fshatrave të komunës, Ndërmarrjet Publike, KEK-u, Policia e Kosovës, Post Telekomit i Kosovës, QKMF-ja, dhe Arkivi.

Neni 17

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit ne Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës te MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të Komunës respektivisht pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli

Festim Neziraj

From: Bashkim Shaqiri
Sent: Thursday, January 16, 2020 9:09 AM
To: Sabrie Rama
Cc: Avni Ahmeti; Florije Kika; Festim Neziraj; Xhevat Tafa; Amir Sogojeva
Subject: RE: Shkrese sqaruese lidhur me shkresen 020-1250/9

Përshëndetje e nderuar,

Agjencia Kadastrale e Kosovës shqyrtoi kërkesën tuaj dhe bazuar në shkresën e bashkangjitur jep këtë përgjigje:

Bazuar në shkresën sqaruese me referencë Nr. 02-104102-792/20, të lëshuar nga Komisioni për Emërtimin, Riemërtimin dhe Shqyrtimin e Ankesave të Rrugëve Lokale të Komunës së Kaçanikut, në të cilën janë dhënë sqarime të nevojshme për të gjitha ato të gjetura të cilat janë të potencuara në përgjigjen e dhënë nga AKK-ë për vlerësim të ligjshmërisë së Vendimit 01.Nr. 104/02-36179/19, **AKK-ë i konsideronë sqarime të mjaftueshme për procedim të mëtutjeshëm**, ndërsa emërtimet e cekura në dy pikat e fundit të kësaj shkrese nuk rekomandohet të përdoren.

Me respekt !



Bashkim Shaqiri

Udhëheqës i sektorit për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit – DL
Agjencia Kadastrale e Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PHONE

MOBILE

 EMAIL

+383 (0)38 200 30 294 +383 44 652 302 bashkim.shaqiri@rks-gov.net

From: Sabrie Rama
Sent: 14-01-2020 09:29
To: Bashkim Shaqiri; Amir Sogojeva
Cc: Avni Ahmeti; Florije Kika; Festim Neziraj; Xhevat Tafa
Subject: RE: Shkrese sqaruese lidhur me shkresen 020-1250/9

Të nderuar,

Ende nuk kemi pranuar një përgjigje lidhur me shkresën e Komunës së Kaçanikut.

From: Sabrie Rama
Sent: Friday, January 10, 2020 9:28 AM
To: Bashkim Shaqiri; Amir Sogojeva
Cc: Avni Ahmeti; Florije Kika; Festim Neziraj; Xhevat Tafa
Subject: FW: Shkrese sqaruese lidhur me shkresen 020-1250/9

Të nderuar,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



REFERENCE:	02-104/02-192/20				
PËR/ZA/TO:	Rozafa Ukimeraj - Sekretare e Përgjithshme në MAPL, Florije Kika- Drejtore e Departamentit Ligjor MMPH-së.				
KOPJE:	/////				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut				
NGA/OD/FROM:	Festim Neziraj, Kryesues i Komisionit për Emërimin, Riemërimin dhe Shqyrtimin e Ankesave të Rugëve Lokale të Komunës së Kaçanikut				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresë sqaruese e Shkresës përcjellëse Nr. 020-1250/9, të datës 06/01.2020				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	09/01/2020
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	

E nderuara znj. Ukimeraj,

E nderuara znj. Kika;

Më datë 08.01.2020, kemi pranuar shkresën përcjellëse nga shkrimorja e MAPL-së se Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr. 104/02-36179/19 ku përmbajtja e saj shpjegon se ky Vendim është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Me të marrë këtë njoftim, ne kemi analizuar me kujdes të gjitha gjetjet e cekura nga ju ku Vendimi i miratuar bie ndesh me legjislacionin në fuqi.

Unë si kryesues i Komisionit dhe anëtarët tjerë kemi punuar afërsisht dy vite duke i analizuar të gjitha kërkesat/ankesat dhe i kemi përgatitur Kuvendit propozim/vendimin se bashku me raportin perfundimtar.

Për ta sqaruar më shumë, analizoni tabelën në vijim:

Emërtimi i Rugës	Shënime nga AKK	Sqarim i Komisionit
Hisen Gashi	Ky emër me vendimin e mëhershëm ekziston në kodin 07_10288 ose si Hysen Gashi dhe nuk mund të përdoren dy herë, (nuk pranohen emrat e ngjashëm)	Në nenin 2.8 të Vendimit, Rr. "Adriatiku" të zëvendësohet me rr. "Hisen Gashi". Në këtë rast kemi të bëjmë me një rrugë të emëruar por që shenja është vendosur gabimisht në terren, andaj nuk është duke u dyfishuar por vetëm teknikisht e përmisueshme dhe në

		këtë rast kemi të bëjmë me të njejtin emër.
Latif Luzha	Ky emër me vendimin e mëhershëm ekziston në kodin 07_10237 dhe nuk mund të përdoren dy herë.	Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me ndërrim tabelash në terren.
Sadik Guri	Ky emër me vendimin e mëhershëm ekziston në kodin 07_10255 dhe nuk mund të përdoren dy herë.	Rruga e tanishme me kodin 07_10255 "Sadik Guri", si rrjedhojë e kërkesës së banorëve që rrugët me emra dëshmorësh të jenë më rëndësishme është zhvendosur në një segment rrugor më të rëndësishëm dhe assesi të dyfishohet. Pra, nuk është dyfishuar emërimi.
Neshat Rexha	Ky emër me vendimin e mëhershëm ekziston në kodin 07_10432 dhe nuk mund të përdoren dy herë.	Rruga e tanishme me kodin 07_10432 "Neshat Rexha", si rrjedhojë e kërkesës së banorëve që rrugët me emra dëshmorësh të jenë më rëndësishme është zhvendosur në një rrugë më të rëndësishme dhe assesi të dyfishohet.
Halilaj	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet.	Rruga "Halilaj" ka arritur si propozim në komision nga kryetari i Fshatit dhe komisioni e ka trajtuar si toponim. Dmth, Halilaj quhet një vend në Fshatin Sllatinë dhe pikërisht ky emërtim është vlerësuar nga komisioni si i ligjshëm.
Lagjja Fazliu	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet.	Meqenëse në kuader të punës së komisionit kemi hulumtuar edhe komunat tjera, kemi parë që termi "Lagjja" në shumë vende është pranuar andaj e kemi pranuar këtë propozim si të ligjshëm.
Qurupaj	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet.	Nuk është duke u emëruar një rrugë e re me emër të tillë, por vetëm përmirësim drejtshkrimor ngase deri tani kjo rrugë figuronte si "Qirupi" dhe në ankesat e banorëve tingëllonte si term fyes për komunitet dhe nga

		komisioni është proceduar vetëm për përmirësim. Gjithashtu ky emër është vlerësuar si toponim.
Shullani	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet.	Fjala "Shullë" apo në të shquarën "Shullani" do të thotë kur një vend është i pjerrët dhe i bie dielli në agim. Asesi nuk është emërtim familjar por futet tek toponimet dhe fjalët popullore të gjuhës shqipe.
Cen Loku	Ky emër me vendimin e mëhershëm ekziston në kodin 07_10386 dhe nuk mund të përdoren dy herë.	Rruga e tanishme me kodin 07_10386 "Cen Loku", si rrjedhojë e kërkesës së banorëve që rrugët me emra dëshmorësh të jenë më rëndësishme është zhvendosur në një rrugë më të rëndësishme dhe assesi të dyfishohet.
Lagja e Re	Nuk rekomandohet emërtimi i rrugës me terma të tillë.	Eksiztojnë me dhjetëra rrugë me emërtim të tillë në Republikën e Kosovës.
Beteja e 28 Shkurtit	Rekomandohen emrat me një ose dy fjalë	Eksiztojnë me dhjetëra rrugë me emërtim të tillë në Republikën e Kosovës. Psh. Rruga në Fshatin Dubravë "Beteja e 25 Majit" etj...


Koment:

Meqenëse është kërkuar që të ndërmarrim veprime të nevojshme të harmonizohet ky Vendim brenda 30 ditësh, ne po ju dërgojmë këtë shkresë me shpjegimet e nevojshme siç i keni të cekura në tabelë.

Vlerësojmë fuqishëm se Vendimi i votuar në kuvend me 2/3 e votave është në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë qështje si dhe është në harmoni me vendimet e kaluara të cilat janë votuar dhe konfirmuar pikërisht nga ministritë në fjalë.

Ne jemi të gatshëm në çdo kohë t'ju japim sqarime të duhura për secilin propozim të paraqitur në Kuvendin e komunës si dhe pjesë e vendimit është raporti i detajizuar.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemajl Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së	
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	Datë: 06/01/2020 Nr.020-1250/9
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Venera Çerkini Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti , Zyrtare i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin e kuvendit të Kaçanikut Nr.01.nr.104/02-36179/19** për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetaret e komunës së Kaçanikut nga komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Ministria e Drejtoria Origjinal	04
Ministria e Drejtoria Kopje	03
Numri i Dokumentit Origjinal	2236-2/19
Numri i Dokumentit Kopje	03.01.20
Drejtoria e 7 B	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Adriana Hoxhiq, Ministre në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Fatmir Matoshi, Ministër i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

E nderuar Ministre,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01 Nr. 104/02-36179/19 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët Komunës së Kaçanikut nga komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, i nënshkruar nga kryetari i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

I miratuar me datë: 17.10.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 23.10.2019

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 13.12.2019

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi 01 Nr. 104/02-36179/19	Vendimi duhet të jetë i bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 12/2012 për Caktimin e Emërtimit dhe Numërtimit të Adresave për Zona të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira. Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2012, përkatësisht nenin 5 Kriteret për emërtimin, paragrafi 1.1., citoj: "Emërtimet ekzistuese nuk dyfishohen brenda territorit të komunës.", paragrafi 1.4., citoj: "Janë të pranueshme dy fjalë për të formuar një emër unik të duhur p.sh.: Rruga Azem Galica. Propozimi i emrave që përbëjnë tre apo katër fjalë nuk janë të rekomanduara." Paragrafi 1.8., citoj: "Emrat e rrugëve të ngjashëm në drejtshkrim apo shqiptim nuk do të pranohet si p.sh. "Rruga Andon" dhe "Rruga Anton"." Në vendimin 01 Nr. 104/02-36179/19, është konstatuar se ka të bëjë me disa emërtime të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e cekura më lartë. Më poshtë gjeni të gjeturat nga Agjencioni Kadastral i Kosovës:

Emri i rrugës	Shënime AKK
Hisen Gashi	Ky emer me vendimin e mehershem egziston ne kodin 07_10228 ose si HYSEN GASHI dhe nuk mund te perdoren dy here, (nuk pranohen emrat e ngjashëm)
Latif Luzha	Ky emer me vendimin e mehershem egziston ne kodin 07_10237 dhe nuk mund te perdoren dy here.
Sadik Guri	Ky emer me vendimin e mehershem egziston ne kodin 07_10255 dhe nuk mund te perdoren dy here.
Neshat Rexha	Ky emer me vendimin e mehershem egziston ne kodin 07_10432 dhe nuk mund te perdoren dy here.
Halilaj	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet
Lagjja Fazliu	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet
Qurupaj	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet
Shullani	Ky emër konsiderohet si emër familjar dhe sipas ligjit nuk lejohet
Cen Loku	Ky emer me vendimin e mehershem egziston ne kodin 07_10386 dhe nuk mund te perdoren dy here.
Lagjja e Re	Nuk rekomandohet emërtimi i rrugës me terma te tille.
Beteja e 28 Shkurtit	Rekomandohen emrat me nje ose dy fjale

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozon MAPL-së që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Vërejtje:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, konstatoi se Vendimi 01 Nr. 104/02-36179/19 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët K.së Kaçanikut nga komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, i nënshkruar nga kryetari i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, është miratuar, me datë 17.10.2019, ndërsa e njëjta është proceduar në MAPL, me datë 23.10.2019, kurse MAPL, po të njëjtin akt e ka përcjellur në MMPH, me datë 13.12.2019.

Andaj, si e tillë, akti i përcjellur nga MAPL në MMPH, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafi 4 dhe nenin 9 paragrafi 2 nenparagrafi 2.1 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ku shprehimisht thuhet: "Ministria, jo më vonë se dy (2) ditë nga data e pranimit të aktit të komunës, me shkresë përcjellëse do të adresoj aktin në ministrinë përgjegjëse për shqyrtimin e ligjshmërisë".



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Komisioni për Emërimin, Riemërimin dhe Shqyrtimin
e Ankesave të Rrugëve Lokale të Komunës së
Kaçanikut

KAÇANIKU



11.11.19	Vendi	KAÇANIK
01	Numri	104/02-5069/18
	Shtojce	1

Bazuar në përgjegjësitë që ka Komisioni për Emërtimin, Riemërtimin dhe Shqyrtimin e Ankesave për Rrugët Lokale me Vendim 01. Nr. 104/02 5069/18 të datës 28/02/2018, pas përfundimit të shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve, konform përgjegjësisë që ka ky komision, iu drejtohet Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me këtë:

R A P O R T

Nëpërmjet këtij raporti të punës, ju njoftojmë se Komisioni për Emërtimin, Riemërtimin dhe Shqyrtimin e Ankesave për Rrugët Lokale, gjatë punës së tij, ka arritur që t'i trajtoj të gjitha ankesat, kërkesat dhe propozimet nga kryetarët e këshillave të fshatrave, lagjeve urbane si dhe qytetarëve të komunës të cilat datonin që nga viti 2015 e deri më tani.

Komisioni, punën e tij e ka bazuar në Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2012 për Caktimin e Emërtimit dhe Numërimit të Adresave për Zonat e Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira.

Meqenëse, pjesë e komisionit në përbërje prej 5 anëtarësh kishte funksionar publik, komisioni është përkujdesur që të respektohet në përpikmëri dispozitat themelore të Ligjit Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, duke i liruar nga vendimmarrja anëtarët në lëndët kur potencialisht mund të kishte konflikt interesi.

Ndër qëllimet kryesore ka qenë edhe mënjanimi i emërtimeve familjare, emërtimeve të papranueshme që bien ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2012 për Caktimin e Emërtimit dhe Numërimit të Adresave për Zonat e Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira. Komisioni, prioritet i ka dhënë emërtimeve të dëshmorëve, toponimeve të ndryshme dhe emrave të përgjithshëm.

Gjatë punës së komisionit, vlerësohet se procesi i emërtimit të rrugëve në të kaluarën është zhvilluar në mënyrë jo të duhur, duke shkaktuar pakënaqësi, keqkuptime e deri tek konflikte midis vëllezërve, fqinjëve, lagjeve, fshatrave dhe palëve të përfshira. Nisur nga këto fakte, komisioni punën e tij e ka bazuar në trajtim të veçantë të të gjitha problemeve, duke i përfshirë edhe përfaqësuesit e lagjeve, vendbanimeve, fshatrave etj, të cilët sipas nevojës, janë ftuar nëpër takime - atëher kur është vlerësuar se prezenca e tyre është e domosdoshme.

Komisioni i ka refuzuar kërkesat me propozime familjare, emra të perveçëm dhe i ka dhënë përparësi emërtimeve të përgjithshme siç janë ngjarjet historike, sakrificat e gjeneratave të cilët kanë kontribuar në çështjen kombëtare, toponimeve etj.

Komisioni ndër tjerash, rëndësi të veçantë i ka dhënë kërkesave të cilat kanë arritur nga qytetarët në formë peticioni me nënshkrime të shumta. Kërkesat ishin të llojeve të ndryshme; disa për ndryshim të emrit, e disa për mos ndryshim, gjë që ka shpërthyer deri te situata të paqarta për neve si komision, ku kemi kërkuar informata shtesë, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Gjithashtu, gjatë punës ekipore, jemi përballur edhe me kërkesa të ndryshme të cilat janë në konteste pronsoro-juridike, e që ne nuk i kemi shqyrtuar duke mos tejkaluar kompetencat tona si komision.

Nga kjo që u raportua më lartë, Komisioni për Emërimin, Riemërimin dhe Shqyrtimin e Ankesave të Rrugëve Lokale të Komunës së Kaçanikut, përveç propozimit që ka dhënë për Kuvend, rekomandon që në procesin e emërimit të rrugëve lokale por edhe më gjerë, të përfshihet edhe niveli qendror dhe të inkuadrohen ekspertë të jashtëm të lemisë në fjalë, ngase vërtetë konsiderohet si i nevojshëm investimi në të ardhmen në sistemin e rrugëve dhe të adresave, por gjithmonë duke pasur parasysh që ndërrimi i shpeshtë i emrave të rrugëve mund të shkaktojë konfuzion dhe nuk rekomandohet.

Komisioni për Emërimin, Riemërimin dhe Shqyrtimin e Ankesave të Rrugëve Lokale të Komunës së Kaçanikut ka vepruar si në vijim:

Lëndë të pranuara:	Të miratuara:	Të refuzuara
93	64	29

Nga ky raport, përkitazi me propozim-vendimin, pasqyrojmë lëndët kryesore të cilat janë shqyrtuar si në vijim:

1. Fshati Begracë

- 1.1 Rr. "Shefki Gashi" të zëvendësohet në rr. "Rilindja"; -fsh. Begracë;
- 1.2 Rr. "Salla Luzha" të përmirësohet në rr. "Sallah Luzha" - fsh. Begracë;
- 1.3 Rr. "Hamdi Trena" të zhvendoset - fsh. Begracë;
- 1.4 Rr. "Qirupi" të përmirësohet në rr. "Qurupaj" - fsh. Begracë;
- 1.5 Rr. "Raif Luzha" të zhvendoset - fsh. Begracë;
- 1.6 Emërtim i ri "Ahmat Luzha" - Jahaj-Kuqishtë- fsh. Begracë- [Luftëtar i vrarë në vitin 1912].
- 1.7 Rr. "Përparim Luzha" të zhvendoset - fsh. Begracë;
- 1.8 Rr. "Adriatiku" të zëvendësohet me rr. "Hisen Gashi" - fsh. Begracë;
- 1.9 Rr. "Toska" të zhvendoset -fsh. Begracë;
- 1.10 Rr. "Mehmet Begraca" të zhvendoset në rr. "Toska" - fsh. Begracë;
- 1.11 Rr. "Mehmet Begraca" riemërohet në rr. "Latif Luzha" - fsh. Begracë;
- 1.12 Rr. "Rifat Gashi" të zëvendësohet në rr. "Fejza" - fsh. Begracë;
- 1.13 Rr. "Kaçakët" të zëvendësohet me rr. "Fejza" - fsh. Begracë;
- 1.14 Rr. "Ili Lakrori" të riemërohet në rr. "Luzha e Ulët"(Refuzohet) [Ili Lakrori ishte mësues i parë i fshatit].

2. Fshati Vatë - Dubravë - Rekë

- 2.1 Rr. "Eksodi 99" të zëvendësohet në rr. "Bajram Curri"; - lagjja Tifek;
- 2.2 Emërtim i ri rr. "Ilir Caka" - lagjja Caka; [Viktimë civile, i vrarë në luftën e fundit].

- 2.3 Rr. "Arbëreshët" të zëvendësohet në rr. "Riza Neziraj" - [Njëri ndër mësuesit e parë në Komunën e Kacanikut si dhe veprimtar i shquar];
- 2.4 Rr. "Hamit Neziraj" të zëvendësohet në rr. "13 Luftëtarët" lagjja Neziraj;
- 2.5 Rr. "Havzi Imishti" të zëvendësohet në rr. "Rrafshi i Përronit" - lagjja Imisht;
- 2.6 "Rrënza e Sharrit" të vazhdohet deri në përfundim të rrugës së lagjes Xhini;
- 2.7 Emërtim i ri rr. "Milazim Krasniqi" [i vrarë në luftën e Bosnjës, ende sot është i zhdukur]- lagjja Imisht;
- 2.8 Emërtim i ri rr. "Kodra e Dushkut" -lidh lagjen Imishti me lagjen Neziraj dhe Dullovi;
- 2.9 Emërtim i ri rr. "Lagjja e Re" - lagjja Mema;
- 2.10 Emërtim i ri rr. "Mërgimtarët" - lagjja Mema;
- 2.11 Emërtim i ri rr. "Nënë Tereza" -lagjja Vishi;
- 2.12 Emërtim i ri rr. "Shefki Vishi" [i vrarë nga Ushtria Bullgare] - lagjja Vishi;
- 2.13 Segmenti rrugor i Rr. "UÇK" të zëvendësohet rr. "Sadik Guri" - degëzimi i rr. "Feriz Guri" deri te rr. "Beteja e 25 Majit" (Pompa te Nikajt deri te Ura e Dubravës);
- 2.14 Rr. "Sadik Guri" të zëvendësohet në rr. "Malsia" - lagjja Malzez dhe Qorraj;
- 2.15 Emërtim i ri rr. "Fetije Qorri" [viktimë civile, e vrarë në luftën e fundit- 25 maj 1999]- lagjja Qorraj - Kamish;
- 2.16 Rr. "Bekim Berisha" të zëvendësohet në "Riza Kasa" [i vrarë në Trogir]-lagjja Kasa;
- 2.17 Emërtim i ri rr. "Tahir Baftiu" [Veteran i UÇK-së post-mortum]- lagjja Vataj;
- 2.18 Emërtim i ri rr. "Sportisti" - lagjja Vataj;
- 2.19 Emërtim i ri rr. "Shullani" - lagjja Vataj - Imisht;
- 2.20 Emërtim i ri rr. "Rezistenca" - lagjja Vishi;
- 2.21 Emërtim i ri rr. "Tahir Sinani" - lagjja Vishi;
- 2.22 Emërtim i ri rr. "Mirëdita" - lagjja Vishi;
- 2.23 Emërtim i ri rr. "Vatra Shqiptare" --- lagjja Vishi;
- 2.24 Emërtim i ri rr. "Qëndresa" - lagjja Imisht;

3. Kaçanik

- 3.1 Rr. "Hasan Prishtina" dhe rr. "Nexhmush Fera"----- të zëvendësohen njëra me tjetrën;
- 3.2 Rr. "Dëshmorët e Kombit", të vazhdohet në segmentin rrugor: Dushkajë - Stagovë;[propozim i Komisionit];
- 3.3 Rr. "Izahir Troni", të vazhdohet deri në segmentin rrugor: Kovaçec - (pompa e Nikajve), [propozim i Komisionit].
- 3.4 Rr. "Martirët e Lirisë" të riemërohet në rr. "Baki Bela"[viktimë civile] - lagjja Beljan.

4. Fshati Biçec

- 4.1 Një segment rrugor i Rr. "Fadil Bunjaku" - të zëvendësohet në rr. "Osman Zharku" (lagjja Zhark segmenti rr, "Avdulla Baftiu" deri te përroni lagjes Shorra);
- 4.2 Një degëzim rrugor i rr. "Sanije Bunjaku" - të zëvendësohet në rr. "Rexhep Mezini"[Veprimtar, ish i burgosur dhe përndjekur nga regjimi i atëhershëm] - lagjja Mezini;
- 4.3 Emërtim i ri rr. "Ushtarët e UÇK"-së - te Hasantë - lagjja Bunjaku -fsh. Biçec;
- 4.4 Emërtim i ri rr. "Ali dhe Adem Sallahu" - viktima civile, lagjja Sallahu;
- 4.5 Rr. "Shahin Palloshi" të zhvendoset - lagjja Palloshi i Poshtëm;
- 4.6 Rr. "Baki dhe Bedri Palloshi" [Refuzohet, emërtime familjare];

4.7 Rr. "Xhevat Sallahu", rruga alternative (rrugë e re) [Refuzohet, emërtim familjar]- fsh. Biçec

4.8 Emërtimi i rr. "Beteja e Biçecit", rruga alternative (rrugë e re) [Ngjarje historike]- fsh. Biçec;

4.9 Emërtim i rr. "Mexhid Bekteshi", [Pjesmarrës në luftën e karadakut] -lagjja Bekteshi fsh. Biçec.

5. Fshati Bajnicë

5.1 Rr. "Cen Loku" të zëvendësohet në rr. "Razim Salihu" [Viktimë e 1945, që është marrur nga xhandarmëria serbe nga shtëpia e tij me duar të lidhura dhe nga ajo ditë nuk dihet për varrin e tij] -fsh. Bajnicë;

5.2 Emërtim i rr. "Qamil Rexhepi" [Viktimë civile e luftës 1999];

5.3 Emërtim i rr. "Lagjja Fazliu";

6. Fshati Kaçanik i Vjetër

6.1 Emërtim i rr. "Cen Loku" - në fsh. Kaçanik i Vjetër;

6.2 Rr. "Neshat Rexha" të zhvendoset nga fsh. Ivajë në fsh. Kaçanik i Vjetër;

6.3 Emërtim i rr. "Brahim Prushi" [Pjesmarrës në luftën e Karadakut] - Kaçanik i vjetër;

7. Fshati Gajre - Ivajë

7.1 Rr. "Avdi Fejzullah Çallaku" të zëvendësohet në rr. "Beteja e 28 Shkurtit" [Ngjarje historike] - fsh. Gajre;

7.2 Emërtim i rr. "Blinaja" - fsh. Gajre;

7.3 Rr. "Dëshmorët e Trogirit" --- në vend të emërtimit të rr. "Neshat Rexha" - Ivajë; [propozim nga komisioni].

8. Fshati Stagovë

8.1 Rr. "Hamdi Hysa" - të zhvendoset - fsh. Stagovë;

8.2 Rr. "TMK-së" të vazhdohet deri te rruga "Rexhep Teneqja" - fsh. Stagovë;

9. Fshati Soponicë

9.1 Dy segmente rrugore "Sharri" dhe "Leka i Madh" - të zëvendësohet vetëm me emërtimin "Sharri" ---- lagjja Prushi - Soponicë;

9.2 Degëzimi i rr. "Sharri" të zëvendësohet në rr. "Remzi Lama" [Veteran i UÇK-së post-mortum]-lagjja Prushi - Soponicë;

10. Fshati Sllatinë

10.1 Emërtim i rr. "Halilaj" - lagjja Halilaj - Sllatinë;

10.2 Emërtim i rr. "Doktor Veseli", [Viktimë civile e luftës së fundit] - fshati Sllatinë;

11. Fshati Gllloboçicë

Emërtim i rr. "Gajur Leka" [Kontribues i çështjes kombëtare dhe mësues] - fshati Gllloboçicë.

Informatat e lëndëve të refuzuara, mund të mirren konform Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Anëtarët e Komisionit

Festim Neziraj

Shpend Krusha

Menduh Krasniqi



Sali Malsiu

Besnik Salihu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 060/01-1918/20
Kaçanik, 31.01.2020

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(d) lidhur me nenet 40.1 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, mbledhjen e vet të mbajtur me 31 Janar 2020, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL PËR
SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2020

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani 01 Nr. 060/01-1918/20 më tekstin e mëtejme: “Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020” i hartuar nga KKSBB.
2. Plani i Punës si në pikën 1. të këtij Vendimi përmban; pikësyzimet në lidhje më objektivat nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të KKSBB, nivelin e realizimit të tyre, dhe numrin e takimeve për gjatë vitit 2020.
3. Plani i Punës së KKSBB, përmban gjithsej 5 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohet: Zyra e Kryetarit të Komunës- përmes saj njoftohen anëtarët e KKSBB dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data 20.01.2020	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01-060	01-1518	/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

PLANI VJETOR I PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL TË SIGURISË NË BASHKËSI, PËR VITIN 2020

Kaçanik, dhjetor 2019

HYRJE

Plani Vjetor i Punësi KKSBS-së përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSBS-së, në përmbushje të qëllimit të funksionimit të KKSBS-së. Plani efektiv i punës ka për bazë strategjinë komunale për përafrimin e objektivave dhe burimeve.

Ky plan i punës synon të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësive për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrativ të KKSBS-së.

KKSBS nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e caktuara në PVP-së, por do të jetë aktive dhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme si dhe përçimin e kërkesave të kësaj natyre.

Po ashtu, KKSBS do të krijojë raporte të rregullta me Kuvendin e Komunës dhe të kërkojë nga legjislativi lokal mbështetjen e funksionimit të KKSBS-së, sikundër edhe përkrahjen e iniciativave dhe projekteve konkrete në të mirë të sigurisë së qytetarëve.

KKSBS do të monitorojë trajtimin nga Komuna të rekomandimeve që dalin nga ky këshill.

PËRBËRJA E KKSBB-së

	Emri e mbiemri	Përfaqësimi	Telefoni	E-mail adresa
1	Besim Ilazi Kryesues i KKSBB-së	Kryetar i Komunës	0290 380005 044 116 133	besim.q.ilazi@ks-gov.net
2	Halim Shehu	Komandanti i Stacionit të Policisë në Kaçanik	0290 380 834 044 219 530	halim.shehu@kosovopolice.com
3	Menduh Rexha	Këshilli i Bashkësisë Islame – Kaçanik	0290 380 076 044 235 718	me.rexha@gmail.com
4	Lirije Luta	Komiteti për Komunitete	044 824 768	lira22@live.com lirije.qeli@rks-gov.net 16.
5	Vedat Dema	Zyra për Barazi Gjinore	044 279386	vedat.dema@rks-gov.net
6	Zahir Doda Koordinator	Drejtor i DAK-së	044 225 351	zahir.doda@rks-gov.net
7	Jashar Selimi	Këshilli i Prindërve	046 164 799	jasha888@hotmail.com
8	Fiton Kastrati	Forca e Sigurisë së Kosovës	049 902 724	fiton.kastrati@fsk-rks.org
9	Shemsedin Abazi	Këshilli Lokal për Siguri Publike	044 224 685	shabazi@hotmail.com
10	Fatmir Çaka Procesmbajtës	Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi	044 346 157	fatmirqaka@hotmail.com
11	Ramadush Osmani	Spektori i Emergjencave Civile	044 414 303	ramadush.osmani@rks-gov.net
12	Fadil Guri	Zyra për Kthim dhe Komunitete	044 228 115	fadil.guri@rks-gov.net
13	Kjani Sallahu	OJQ-të, Mediet, Bizneset, PAK-të	044 164 710	kjani_s@hotmail.com

ORARI I TAKIMEVE TË KKSBB-së - 2020

	Periodha	Koha	Vendi	Rendi i punës	Pjesëmarrja
1	17-24 shkurt 2020	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Dukuria e vjedhjeve masive në disa lokalitetet të komunës së Kaçanikut 3. Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSBB-së, gjatë vitit 2019 4. Të ndryshme	Policia, Prokuroria, gjykata
2	13-20 Prill 2020	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Identifikimi në terren dhe prezantimi i problemeve urgjente të sigurisë 4. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së
3	15-22 Qershor 2020	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Inicimi dhe përzgjedhja për realizimin e një projekti të sigurisë 4. Mobilizimi për parandalimin e rreziqeve të mundshme gjatë sezonit veror (zjarret, trafiku i automjeteve... 5. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së Zjarrëfikësit
4	10-17 Gusht 2020	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Trajtimi i ankesave të qytetarëve për sigurinë 4. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së Komisioni i Ankesave
5	12-19 Tetor 2020	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Trajtimi i ambientit dhe menaxhimi i mbeturinave gjatë stinës së verës 4. Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës, për vitin 2021 5. Të ndryshme	OMM "Gjethi" NRMM "Pastërtia"
	14-21 Dhjetor 2020	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Përgatitja e përballjes me sfidat me kushtet klimatike dimrore 4. Trajtimi i temës së ekstremizmit Aprovimi i Planit Vjetor të Punës 2020 5. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së

Plani Vjetor i Punës së KKSBB-së është orientues dhe jo domosdoshmërisht do të kufizohet vetëm në pikat e sipërpërmendura. Ky këshill do të trajtojë edhe tema të tjera, varësisht nga kërkesat dhe zhvillimet gjatë këtij viti.

Në përputhje me nenin 11, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ të KKSBB, kjo e fundit mund të mbajë edhe takime të tjera, varësisht nga nevojat e paraqitura në ndërkohë.

TAKIME TË JASHTËZAKONSHME - VARËSISHT NGA ZHVILLIMET

OBJEKTIVAT E KKSBB-së NË PVP 2020

KKSBB do të interesohet edhe në kërkimin e donatorëve të brendshëm e të jashtëm për zbatimin e projekteve konkrete në lëmin e sigurisë, fushata vetëdijesuese, etj. KKSBB do të shqyrtojë edhe çështje të tjera të cilat ndërlidhen me objektivat, detyrat dhe kompetencat e këtij organi konsultues:

- Trajtimi i temave të ekstremizmit
- Iniciativat e përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë
- Përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve, për çështjet që lidhen me sigurinë e jetës së tyre
- Zhvillimin e projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi
- Identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike
- Rekomandimin e planeve të veprimit
- Bashkëpunimin me strukturat e sigurisë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi
- Informimin e Kuvendit Komunal dy here brenda vitit për aktivitetet e KKSBB-së

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi në komunën e Kaçanikut, edhe gjatë vitit 2020 do të jetë në funksion të realizimit të objektivave, konform rolit dhe kompetencave që ka. Ndër objektivat e KKSBB-së, më me përkushtim do të trajtohen:

- Identifikimi i problemeve që cenojnë sigurinë e qytetarëve
- Inicimin e zgjidhjeve të problemeve që kërcënojnë sigurinë publike dhe jo vetëm
- Thirrje për vetëdijësimin e qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve
- Parandalimi i veprimeve të dhunshme
- Rekomandimin e planeve të veprimit dhe adresimi i shqetësimeve të qytetarëve te institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive të komunës së Kaçanikut

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi poashtu, do të ofrojë mundësinë për adresimin e gjerë të problemeve me të cilat mund të përballen qytetarët, siç janë: siguria në shkollë, e cila mund të trajtohet në nivelin lokal përmes koordinimit të organeve të shkollës, prindërve, mësimdhënësve, Drejtorisë së Arsimit, drejtorive komunale përkatëse, policisë dhe akterëve të tjerë.

KKSBB-së do të trajtojë ide, plane, propozime, sugjerime dhe projekte konkrete për fushën e sigurisë publike dhe jo vetëm.

Ky organ konsultues komunal, do të diskutojë edhe tema të tjera që ndërlidhen me veprat penale e kundërvajtëse, me theks të veçantë: përdorimin e armëve nëpër ahengje familjare dhe organizime të ndryshme, sigurinë në komunikacion, përhapjen e zjarreve, prezencën e qenëve endacakë dhe rrezikun e shumfishtë nga kjo kafshë pa pronar, përdorimin e substancave narkotike nga të rinjtë, sigurinë në shkolla, mbeturinat në rrugë e në hapësira publike, vjedhjet individuale dhe të organizuara, prishjen e qetësisë publike, lirim të hapësirave publike për sigurinë e lëvizjes së qytetarëve, sigurinë e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e ambientit, sigurinë higjienike e sanitare të hapësirave të cilat frekuentohen dhe shfrytëzohen nga qytetarët, sigurinë e konsumatorëve nga produktet ushqimore, etj.

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi, siç është përmendur edhe më lart, do të insistojë në kërkesat e donatorëve dhe institucioneve lokale, për financimin e projekteve konkrete të cilat do të implementohen nga qeveria komunale.

Projektet më me prioritet, disa prej të cilave vazhdojnë që disa vite t'i prijnë listës, janë:

- Trajtimi i dukurisë së vjedhjeve dhe dukurive të tjera të cilat e dëmtojnë qytetarin e komunës së Kaçanikut
- Rregullimi i infrastrukturës fizike (pjerrinave, ashensorëve, shkallëve emergjente) nëpër institucione
- Ndërtimi i trotuareve për sigurinë e qytetarëve në lokalitetet në të cilat mungojnë ato
- Vendosja e kamerave të sigurisë në institucione dhe në hapësira publike
- Vendosja e pengesave (policëve të shtrirë) nëpër lokacione urbane e jurbane, sidomos afër shkollave
- Vendosja e hidrantëve publik nëpër rrugët kryesore të qytetit, për përgjigje të shpejtë dhe efikase ndaj përhapjeve eventuale të zjarreve
- Largimi i deponive të egra
- Parandalimi hulumizmit nëpër shkollat e komunës
- Luftimin e narkomanisë dhe dukurive tjera negative
- Adresimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve

Plani i punës i KKS-së do të zbatohet në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe 03/2012 të MAPL-së dhe si i tillë, nga anëtarët e KKS-së i përcillet për miratim KK të Kaçanikut.

Kaçanik, 19.12.2019

Grupi Punues i PVP-së:

Zahir Doda

Kjani Sallahu

Lirije Luta



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-2076/20
Kaçanik, 31.01.2020

Në bazë nenit 13.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 –për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 Janar 2020, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA, PËR PERIUdhËN: SHtATOR- DHJETOR 2019

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për periudhën, Shtator-Dhjetor 2019, respektivisht nga data e anëtarësimit në këtë komitet.
2. Në Raportin e Punës së Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara është paraqitur aktiviteti i zhvilluar i këtij komiteti përmes mbledhjeve të rregullta dhe aktiviteti tjetër, me qëllim të arritjes së përmirësimit të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara i përmbledhur në gjithsej, 12 faqe / Lënda: 01Nr. 60/01-2076/20.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:, Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, Kryetari i Komunës, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Data	21.01.20	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	60/01-2076
		Shtojcë	✓

Data / Datum	21.01.2020
Për / Za	Kuvendin e Komunës- Kaçanik
Përmes / Preko	Artan MEZRAJA, Kryesues i KKPAK -Kaçanik
Nga / Od	Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara
Kopje / Kopija	
Lënda / Predmet	Raporti i Punës së KKPAK-së për vitin 2019

Të nderuar;

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik e ka hartuar Raportin e Vjetor të Punës së KKPAK-së për periudhën e vitit 2019 andaj si material përcjellës të kësaj shkrese të bashkangjitur e keni edhe Raportin vjetor të punës së këtij komiteti.

Me respekt;

Artan Mezraja

Kryesues i KKPAK-Kaçanik.



Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

Republika Kosova

Opština Kaçanik

Republic of Kosovo Municipal Kaçanik

Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara për Periudhën Shtator- Dhjetor 2019

Kaçanik, 2020

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e Shkurtesave.....	3
Fjala e Kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara.....	4
Përmbledhja ekzekutive	6
I. Mbledhjet.....	8
II.Takimet	9
III. Hartimi i Planit të Punës 2020.....	9
IV. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2018-2019..	9
V.Kërkesat drejtuar institucioneve komunale.....	10
VI.Aktivitetet Avokuese/Marrëveshjet.....	10
VII.Vizitat studimore.....	11
VIII.Sfidat/Rekomandimet.....	12
VIV. Shtojca	

Lista e Shkurtesave

PAK –Personat me Aftësi të Kufizuara

PLVPAK- Plani Lokal i Veprimit Për Personat me Aftësi të Kufizuara

KKPAK- Komiteti Konsultativ Për Persona me Aftësi të Kufizuara

ZBDNJ- Zyra për Barazi dhe të Drejta të Njeriut

Fjala e Kryesut të KKPAK-së

I nderuari Kryesues i Kuvendit Komunal të Kaçanikut, z. Kemajl Murseli,

Të nderuar anëtar,

Fillimisht pjesën e raportit e filloj me një falënderim për ju personalisht dhe anëtarët e Kuvendit në përgjithësi, në radhë të parë për themelimin, si dhe për qasjen konstruktive ndaj Komitetit. Kjo për ne si trupë këshilldhënëse është tepër e nevojshme dhe e vlerësueshme. Gjithashtu mirënjohje për profesionalizmin dhe asistencën e pakursyer të treguar ndaj Komitetit nga ana e dy zyrtareve të Kuvendit Komunal të Kaçanikut.

Në kuadër të obligimeve të legjislacionit në fuqi në raport me KKPAK-në përkatësisht Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr 01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, ne si Komitet paraqesim raportin e punës përgjatë vitit kalendarik 2019, ndonëse siç dhe ju e dini se ky Komitet është themeluar më datën 13.09.2019, prandaj edhe raporti është i referueshëm përgjatë kësaj periudhe.

Një ndër grupet më të marginalizuara në botën bashkëkohore, jo vetëm në shoqërinë tonë, por edhe në pjesë të ndryshme të globit social janë komuniteti i personave me aftësi të kufizuara. Shumësia e marginalizimit është multidisiplinare. Në këtë kontekst, si përgjigje ndaj kësaj është themeluar Komiteti që të shërbej si një zë më shumë i këtij komuniteti në procesin e vendimmarrjes në Komunën e Kaçanikut.

Ndonëse si Komitet i themeluar për herë të parë në Komunën e Kaçanikut, përgjatë kësaj periudhe të aktiviteteve, jemi munduar që punën tonë ta fokusojmë në avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar, duke u munduar që atë ta ngrisim në nivele të prioriteteve në dy drejtime; në atë institucional dhe në atë shoqëror.

Të nderuar anëtar,

Ndonëse përvoja e pakt si Komitet, megjithatë, ajo përgjatë kësaj periudhe na ka shërbyer që të konstatojmë se problemet dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara në komunën tonë janë

tëmëdha, mirëpo ne si Komitet kemi shpresë dhe bindje se një qasje mëproakive, një kordinim më i mirë institucional,dhe një vullnet i përgjithshëm është garancion në arritjen e qëllimit tonë të përbashkët:përmirësimin e çështjës së aftësisë së kufizuar në Komunën tonë. Nëse fillimiikësaj fjale ishte me falenderime, përfundimi do të jetë si ftesë për një angazhim më të madh përgjatë vitit 2020.

Me respekt,

Artan Mezraja

Kryesues i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Përmbledhja ekzekutive

Ky raport paraqet punën dhe aktivitetet e ndërmarra nga ana e Komitetit për gjatë periudhës shtator- dhjetor 2019. Menjëherë pas seancës konstitutive të mbajtur më 13.09.2020, Komiteti ka zhvilluar një numër takimesh, për të përcaktuar agjendën e punës së komitetit përgjatë kësaj periudhe të mbetur të vitit 2019. Të ndodhur në një presion kohor të tillë Komiteti është angazhuar maksimalisht në arritjen e disa synimeve.

Në raport përfshihen aktivitetet e zhvilluara të Komitetit që kanë të bëjnë me marrëjen epërvojave më të mira nga komitetet homologe në komunat tjera të cilat kanë qenë të dobishme në punën tonë në vazhdim. Gjithashtu, brenda këtij pasqyrimi të punës sonë do të gjeni aktivitetet e ndërmarra për promovimin e Komitetit në takime njoftuese si brenda institucioneve lokale, ashtu edhe jashtë institucioneve në takime me shoqërinë civile e veqanarisht me organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara.

Në përjashtim, të mbledhjes konstituive, Komiteti ka mbajtur edhe mbledhje të rregullta në të cilën janë shqyrtuar çështje të ndryshme në të cilat kanë dominuar përgatitjet e planit të punës për vitin 2020 si dhe hulumtimin e pasqyrës së gjendjes së personave me aftësi të kufizuara në Kaçanik.

Gjithashtu një pjesë e aktiviteteve ka qenë e rezervuar në monitorimin e Planit të Veprimit të Personave me Aftësi të Kufizuara 2019-2021 të miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut. Brenda këtij raporti janë pasqyruar edhe aktivitetet që Komiteti ka bërë jashtë institucioneve me qëllim ndërmjetësimin dhe lehtësimin e disa marrëveshjeve ndërmjet bizneseve të ndryshme dhe organizatave të cilat përfaqësojnë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst kjo periudhë 3 mujore është përmbyllur me arritjen e dy marrëveshjeve në formë të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet një “biznesi privat” dhe organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, ku Komiteti si palë nënshkruese e këtyre marrëveshjeve ka rolin e ndërmjetësuesit si dhe lehtësuesit në arritjen dhe implementimin e këtyre marrëveshjeve.

Korniza Ligjore

Komitetet Konsultative janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet e komunave të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve. Si të tilla ato mund të angazhohen në: dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme; hulumtime të ndryshme; japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e Përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse; paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës; japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Baza e funksionimit të këtyre komiteteve mbështetet në këto dokumente ligjore: Ligjin Nr 03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në Udhëzimit Administrativ(MAPL)Nr.01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

Përberja:

Artan Mezraja Kryesues

Mirlinda Axhami Anëtare

Antigona Axhami Baftijaj Anëtare

Edita Shehu Anëtare

Albana Fuga Anëtare

Fiknete Krasniqi Anëtare

Argjenta Axhami Anëtare

I.Mbledhjet

Në bazë të Udhëzimit Administrativ(MAPL)Nr.01.2016 për Procedurën e Themelimit,Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna mbledhjet janë të përcaktuara në bazë të“nevojave që së paku të mbahen gjashtë(6)takime në vit”.Ndonëse si shumë të nevojshme, Komiteti ka mbajtur vetëm dy mbledhje të rregullta(duke përjashtuar mbledhjen konstituive të thirrur nga Kryesuesi i Kuvendit)duke ndjekur një politikë kursyese ndaj rimbursimit të mëditjeve për anëtarët e Komitetit dhe duke i zëvendësuar këto me shumë takime tjera të pakompenzueshme.

Në mbledhjen e parë(mbledhja konstituive) e cila është mbajtur me datën 13.09.2019 e cila është thirrur nga Kryesuesi i Kuvendit të Kaçanikut z. Kemajl Murseli dhe udhëhequr nga po i njëjti është bërë njoftimi ndërmjet anëtarëve dhe kryesuesit ku janë diskutuar detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit si dhe është bërë zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit i cili me shumicë absolute u zgjodh z. Artan Mezraja.

Mbledhja e dytëështë thirrur nga kryesuesi i Komitetit e cila është mbajtur me datën 21.10.2019 ku janë trajtuar çështje të tilla si planifikimi i aktiviteteve të Komitetit për gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019, hartimi i një plani të punës për vitin 2020, si dhe planifikimi i disa vizitave me qëllim promovimin e Komitetit por edhe marrjen e informacioneve të ndryshme në raport me gjendjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Kaçanikut. Në këtë mbledhje është dakorduar që disa anëtarë të marrin pjesë në tryezat dhe takimet ku për fokus kanë çështjen e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu në këtë takim është propozuar që të fillojmë me monitorimin e zbatimit të PLVPAK-së si dhe është bërë ndarja e fushave për monitorim për secilin anëtarë të komitetit.

Mbledhja e tretë është mbajtur me datën 16.12.2019në të cilën është miratuar plani i punës mbi të cilin Komiteti do të punoj gjatë vitit 2020. Gjithashtu brenda kësaj mbledhje secili nga anëtarët ka paraqitur analizën me të dhënat lidhur me zbatimin e PLVPAK-sënë secilën objektiv të monitoruar. Ide të ndryshme në lidhje me punën e Komitetit si dhe mënyra më të mira për angazhim, kan qenë pjesë e diskutimeve në këtë mbledhje.

II. Takimet

Duhet theksuar se këto aktivitete janë ndarë në dy pjesë. Në pjesën e takimeve ndërmjet anëtareve të Komitetit e cila duhet thënë që ka qenë metodologjia kryesore e punës sonë dhe se takimet e tilla janë të “panumërueshme” në të cilën janë dhënë ide, është punuar në draftimin e dokumenteve si plani i punës, kërkesa të ndryshme apo dhe diskutime lidhur me gjetjet e zbatimit të PLVPAK-së. Ndërsa, takimet tjera janë realizuar me Kryetarin e Komunës z. Besim Ilazi i mbajtur me datën 25.10.2019, ky takim kishte karakter njoftues por edhe i’u është dhënë një pasqyrë mbi gjendjen e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara në Kaçanik. Në mënyrë verbale i’u janë adresuar disa çështje që si komunë do të duhej me intervenuar (Lexo më shumë tek pjesa e kërkesave...). Gjithashtu takime tjera janë realizuar edhe me Kryesuesin e Kuvendit z. Kemajl Murseli i mbajtur me datën 24 dhjetor, takim i cili ka shërbyer edhe si komunikim lidhur me punën e Komitetit si dhe sfidat e ndryshme.

Me datën 14.11.2019 është realizuar një takim me përfaqësuesit e organizatës që përfaqësojnë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara në Kaçanik Handikos-Kaçanik. Qëllimi i këtij takimi ka qenë marrja e informatave mbi fusha të caktuara për komunitetin e PAK-ve si dhe mundësitë për bashkëpunim ndërmjet Komitetit dhe Handikos në Kaçanik por edhe adresimin dhe avokimin e çështjes e aftësisë së kufizuar tek institucionet dhe mekanizmat tjerë jashtëinstitucional.

III. Hartimi i Planit të Punës

Dokument referues mbi punën dhe aktivitetet e Komitetit për vitin 2020 do të jetë “Plani i Punës së KKPAK-së për vitin 2020”. Një pjesë e madhe e punës në kuadër të takimeve është rezervuar në raport me hartimin e këtij plani, duke shfrytëzuar edhe modele të ndryshme të planeve nga komitetet “homologe” të komunave tjera. Nëse pjesa e tremujorit të parë të punës së Komitetit ka qenë më shumë “ad hoc” tanimë për vitin 2020 ky dokument përmban të gjitha aktivitetet e datuara të Komitetit përgjatë vitit 2020.

IV. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021

Një nga aktivitetet ku është konsumuar kohë në punën e Komitetit ka qenë edhe Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021. Ky monitormim

ështëbërë duke përdorur dy lloje metodash , atë të vrojtimit të drejtpërdrejtë si dhe metodën e intervistimit të shumë bartëseve të institucioneve lidhur me të gjitha objektivat e parapara në këtë dokument. Në përgjithësi janë realizuar 10 takime me bartësit e institucioneve të listuar në dokumentin e PLVPAK-së si institucione përgjegjëse për zbatimin e këtij plani. Gjetjet dhe raporti i veçantë i këtij monitorimi do të i'u dorëzohet Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës brenda këtij viti.

V.Kërkesat

Si pjesë e punës sonë ka qenë edhe dëgjimi i kërkesave të personave me aftësi të kufizuara dhe adresimi i tyre tek autoritetet komunale, një nga këto kërkesa në formën verbale(adresuar tek Kryetari i Komunës) ka qenë edhe sigurimi i një zyre për njërën prej organizatave që përfaqësojnë komunitetin e PAK-ve në Kaçanik të quajtur EMPOWER. Duhet theksuar se zotimi i kryetarit ka qenë që me përfundimin e punimeve ose në Palestren Sportive ose në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” (ku po renovohej një pjesë e objektit për hapjen e një Qendre Rinore) do të vendoset organizata EMPOWER. Komiteti deri sa po shkruhet ky raport nuk ka një konfirmim nëse është realizuar ose jo.

Duke qenë se një nga detyrat e Komitetit është edhe hulumtimi dhe adresimi i çështjeve të ndryshme, në këtëkontekst Komiteti pas realizuar “mbikqyrje” të punimeve rreth objektit të xhamisë,në rrugën Idriz Seferi, si dhe pas një konsulte me drejtuesit e Handikos në Kaçanik ka vërejtur që këto punime nuk janë duke u bërë sipas standardeve të kërkuara për qasje fizike për PAK-të. Duke e parë këtë, Komiteti me datë18.11.2019 në adresë të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Kadastrës, Mjedisit si dhe Kryetarit të Komunës ka dorëzuar një kërkesë më shkrim ku ka kërkuar që këto punime të bëhen sipas standardeve të kërkuara për qasje fizike për komunitetin PAK. Duhet theksuar se punimet kanë përfunduar dhe gjendja në raport me qasjen është e pandryshuar. Veçojmë po ashtu se Komitetit nuk i'u është kthyer asnjë përgjigje në lidhje me kërkesën e adresuar.

VI.Aktivitetet avokuese /Marrëveshjet

Avokimi i çështjes së aftësisë së kufizuar nga ana e Komitetit është munduar të bëhet në shumë mënyra në të gjitha rastet e dhëna, veçojmë angazhimin tonë në dy drejtime: Pjesëmarrja në tryeza të caktuara ku është diskutuar për çështjen e aftësisë së kufizuar si dhe avokimin në

drejtim të individëve e bizneseve me potencial për të kontribuar drejtë avancimit të pozitës së PAK-ve në Kaçanik.

Anëtarët e Komitetit kanë qenë prezent në këto tryeza :

- Identifikimi i problemeve dhe sfidave të PAK-ve në Kaçanik me datën 22.10.2019 të organizuar nga ZBDNJ.
- Tryeza: Gjendja e PAK-ve në Komunën e Kaçanikut me datën 03.12.2019 organizuar nga Handikos-Kaçanik

Gjithashtu, Komiteti ka qenë prezent në një aktivitet me karakter socializues në Kaçanik me datën 29.11.2019 organizuar nga ZBDNJ dhe Handikos-Kaçanik.

Duke qenë të vetëdijshëm në burimet e kufizuara të komunës por dhe në përgjithësi të institucioneve në Kosovë, ne mendojmë që çështja dhe përmirësimi i pozitës së PAK-ve ndodhë edhe duke kërkuar miq dhe aleat në kompani të ndryshme të cilat mund të përkrahin aktivitete ose ofrojnë shërbime në të mirë të komitetit për PAK. Në këtë kontekst Komiteti ka shtrirë fushën e ndikimit edhe jashtë institucioneve duke arritur që të ndërmjetësojë nënshkrimin e dy marrëveshjeve në formën e memorandumeve të mirëkuptimit ndërmjet dy organizatave që përfaqësojnë PAK-të në Kaçanik dhe Ordinancës Stomatologjike “Mici Dent”, Përmbajtja e kësaj marrëveshje është kontributi financiar mujor për 12 muaj për secilen organizatë, shërbime stomatologjike falas për të gjithë PAK-të, si dhe me çmime me përqindje zbritje (për më shumë shih marrëveshjet të bashkangjitur këtij raporti).

VII. Vizitat studimore

Duke qenë se si Komitet i tillë jemi themeluar për herë të parë, për ne ka qenë më se e nevojshme marrja e praktikave dhe studimi i tyre nga historia e punës së komiteteve të tjera në komunat tjera. Në fakt takimi i parë dhe aktiviteti i parë që ka bërë Komiteti është, ku me datën 08.10.2019 ne kemi realizuar një vizitë te Komiteti Konsultativ për PAK në Komunën e Prishtinës ku qëllimi i këtij takimi ka qenë marrja e eksperiencave më të mira të funksionimit të KKPAK-së në Prishtinë si dhe mundësitë e bashkëpunimit për adresim të çështjeve të aftësisë së kufizuar në institucionet lokale dhe qëndrore.

VIII.Sfidat

Të vetëdijshëm se sfidat janë pjesë e përditshme në secilën veprimtari edhe ne si Komitet jemi ballafaquar me disa prej tyre:

- Periudha e vonshme e themelimit të Komitetit.
- Pezullimi i aktiviteteve deri në përfundim të procesit zgjedhor 2019(deri me 8 tetor2019).
- Kordinimi i takimeve me të gjithë anëtarët marrë parasysh oraret e ndryshme të aktiviteteve të përditshme të tyre.
- Mungesa e njohurive të disa përfaqësuesve institucional lidhur me detyrat e Komitetit.
- Mungesa e ID kartelave për anëtarët e Kuvendit si shenjë prezantimi.
- Mospërgjigjja në kërkesat e Komitetit nga ana e autoriteteve Komunale etj.

Rekomandimet

Duke qene se së shpejti do e keni edhe një Raport të Monitorimit mbi gjetjet në lidhje me zbatimin e PLVPAK-ve, raport i cili do përmban pasqyrim, kritik, alternativa dhe rekomandime konkrete,tani po fokusohemi në disa rekomandime:

- Të institucionalizohet sa më shume çështja e PAK-ve.
- Të prioritzohet zbatimi i PLVPAK-së nga ana e qeverisjes komunale.
- Rekomandojm që të merrni pjesë në takimet, aktivitetet socializuese që organizatat e PAK-ve ndërmarrin për PAK-të.
- Institucionet e adresuara të i'u përgjigjen kërkesave të Komitetit.
- Institucionet e adresuara të marrin parasysh rekomandimet e Komitetit.
- Komiteti të trajtohet si pjesë e Kuvendit edhe gjatë vizitave të ndryshme jashtë shtetit në mënyrë që këto vizita Komitetit të i shërbëjn në marrjen e përvojave dhe modeleve të ndryshme në raport me çështjet e PAK-ve.
- Anëtarët e Komitetit të paisen me ndonje ID kartel si shenje prezantimi në raste të caktuara.
- Mbledhjet e Komitetit të pasqyrohen në mjetet e informimit të komunës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-2249/20
Kaçanik, 31.01.2020

Në bazë të nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, 01 Nr.7864/2008 të datës 13.11.2008, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 Janar 2020, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME
PUBLIKE, PËR VITIN 2020

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2020, i propozuar nga Komiteti për Shërbime Publike të Kuvendit të Komunës.
2. Në Planin e Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020, janë paraqitur, objektivat e këtij Komiteti, numri i mbledhjeve dhe periudhat e mbajtjes së mbledhjeve.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, i përmbledhur në gjithsej, 1 faqe +ballina/ Lënda : 01 Nr. 60/01-2249/19.
4. Për zbatimin e Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike do të kujdeset: Komiteti për Shërbime Publike dhe organet tjera relevante të komunës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Komiteti për Shërbime Publike, Kryetari i Komunës, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



I	Data	22.01.20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	Nr. 60/01-2249			/.

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE, PËR VITIN 2020

Kaçanik, Dhjetor 2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-12813/2018
Kaçanik, 27.04.2018

Në bazë të nenit 17, 51.2 dhe 40.2 (e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 6.2 (f) lidhur me nenin 39.2 alineja 2 e Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-12813/18 prej datës 20.04.2018., Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 Prill 2018, mori këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

1. Me këtë Vendim, formohet Komiteti për Shërbime Publike, i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut.
2. Komiteti për Shërbime Publike, përbëhet prej 5(pesë) anëtarëve nga radhët e Kuvendit të Komunës, duke reflektuar përfaqësimin politik në kuvend, dhe atë:

1. Hamid Guri	PDK	anëtar,
2. Lirije Shurdhani-Dema	PDK	anëtare,
3. Adnan Reka	AAK	anëtare,
4. Arlinda Rakoci-Raka	LDK	anëtare dhe
5. Afërdita Shehi	AAK	anëtare.
3. Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këtij Komitetit.
4. Ky Komitet ka për detyrë të mbështesë dhe monitoroj punën e drejtorisë komunale për Shërbime Publike si dhe shërbimet publike në përgjithësi.
5. Funksionimi dhe kompensimi i këtij Komiteti do të rregullohet me akt nënligjor.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.
7. Pas aprovimit në Kuvend, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe 7 ditë Publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Shërbime Publike, Kryetari i Komunës, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë, MAPL, BIRK Arkivi.



Hyrje

Kuvendi Komunal në mbështetje të dispozitave të nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale dhe nenit 31 dhe 32.1.2.3 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, dhe në bazë të mandatit të dhënë Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, në mbledhjen e vetë të mbajtur në prill të vitit 2018, mori vendim për themelimin e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike si trupë këshilldhënëse e KK, në përbërje prej 5 antarëve.

Kuvendi komunal krijon komitetet konsultative sektoriale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendim-marrës. Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve, kuvendi komunal duhet të sigurojë një përfaqësim të gjerë duke marrë parasysh balancën gjinor dhe ato duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese brenda komunës.

Komitetet konsultative duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kuvendi i Komunës. Ata gjithashtu duhet të monitorojnë ofrimin e shërbimeve në sektorët relevant dhe të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjedhjen e problemeve të identifikuar. Në kryerjen e detyrave të tyre komitetet konsultative duhet të punojnë së bashku me komitetet e kuvendit në mënyrë të tillë që, vendimet e komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit plenar duhet të merren vetëm pas konsultimit me komitetin konsultativ sektorial.

Komitetet konsultative duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kuvendi i Komunës.

Komitetet konsultative gjithashtu mund të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjedhjen e problemeve të identifikuar.

Kaçanik, dhjetor 2019

Kalendari i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020

Takimet	Periudha kohore e takimeve	Vendi i takimit	Aktivitet dhe qështjet për t'u diskutuar	Kryesuesi i takimeve
Takimi I	Pjesa e parë e muajit shkurt	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Shqyrtimi i raportit vlerësues rreth performancës së Komunës - Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019 - Informatë rreth sektorit të emergjencave të Komunës - Raport rreth gjendjes dhe mirëmbajtjes së rrugëve gjatë sezonit dimëror	Kryesuesi i KSHP
Takimi II	Pjesa e parë e muajit mars	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Informatës mbi raportin e punës së KRU "Bikfurkacioni" njësia në Kaçanik - Informatës mbi raportin e punës së KRM "Pastërtia" njësia në Kaçanik - Informatë rreth mbrojtjes së mjedisit në Komunë	Kryesuesi i KSHP
Takimi III	Pjesa e parë e muajit maj	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Shqyrtimi i marrëveshjes për financimin e shërbimeve të varrimit - Raporti i punës së Inspektorit të Mjedisit - Informatë rreth gjendjes dhe mirëmbajtjes verore të rrugëve në Komunë	Kryesuesi i KSHP
Takimi IV	Pjesa e parë e muajit qershor	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Takim publik me qytetarë - Informatë rreth menagjimit të hapsirave publike - Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë	Kryesuesi i KSHP
Takimi V	Pjesa e parë e muajit shtator	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Informatë mbi raportin e vlerësimit të performancës së Komunës - Informatë rreth funksionimit të sistemit të kanalizimit dhe ujërave atmosferik - Informatë rreth ndriçimit publik	Kryesuesi i KSHP
Takimi VI	Pjesa e parë e muajit nëntor	Kati II. Salla e Komiteteve të KK	- Informatë rreth përgatitjes për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror - Takim publik me qytetarë - Hartimi i planit të punës së KSHP për vitin 2021	Kryesuesi i KSHP

Kryesuesi i KSHP

Hamid Gutli

Kaçanik, dhjetor 2019



01 Nr. 60/01-36408/19

Kaçanik, 31.01.2020

RREGULLORE NR. 01/2020

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01/2018
(01.NR 02-104/01-11899) PËR BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
VENBANIMET, FSHATRAT DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS
SË KAÇANIKUT**

Janar 2020

Faqe 1 nga 4

RREGULLORE PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES 01/2018 (01.NR 02-104/01-11899) PËR
BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME VENBANIMET, FSHATRAT DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË
KAÇANIKUT

Në mbështetje të nenit 11 lidhur me nenin 12.2 (c) dhe nenit 17 (s) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/4 Qershor 2008), të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur më 31 Janar 2020, miratoi këtë:

RREGULLORE Nr. 01/2020

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01/2018 (01.NR 02-104/01-11899) PËR BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME VENBANIMET, FSHATRAT DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Neni 1

Me këtë Rregullore, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01/2018 (01. Nr. 02-104/01-11899) për Bashkëpunimin e Komunës me Vendbanimet, Fshatrat, dhe Lagjet Urbane të Komunës së Kaçanikut e datës 27.04.2018.

Neni 2

Ndryshohet neni 3, paragrafi 2, me tekstin në vijim: "Komuna e Kaçanikut themelon 20 Zona të përbëra prej këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe jo formale dhe lagjeve urbane dhe do të paraqiten në listë të veçantë, Shtojca Nr. 1. që do të jetë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje".

Neni 3

Ndryshohet neni 4, paragrafi 1, me tekstin në vijim: "Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar procesin në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë: katër (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një (1) anëtar nga ekzekutivi, (1) një nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Komisioni do të reflektoj përfaqësim gjinor dhe etnik. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit".

Neni 4

Ndryshohet përmbajtja e paragrafit 6, të nenit 4 me tekstin në vijim: "Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës".

Neni 5

Faqe 2 nga 4

Shtohet paragraf i ri në nenin 4, me tekst në vijim “Komisioni raporton para Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor”.

Neni 6

Në nenin 5, paragrafi 1, ndryshohet numri i anëtarëve si në vijim: “Këshillat lokale do të kenë pesë (5) deri nëntë (9) anëtarë”.

Neni 7

Shtohet fjalia te neni 5, paragrafi 2, me tekstin në vijim: “Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane”.

Neni 8

Ndryshohet neni 6, paragrafi 5, me tekstin në vijim: “Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit, komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të organizoj zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri”.

Neni 9

Shtohet paragraf i ri në nenin 6, me tekst në vijim: “Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes me aprovimin e komisionit të kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh”.

Neni 10

Hiqet në tërësi përmbajtja e nenit 13, dhe shtohen paragrafët me tekst në vijim:

1. “Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i Komunës së Kaçanikut.
2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale, bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative për takim.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.
4. Kompensimi bëhet në ndarje të barabartë për kryetarët e këshillave lokale të cilët vijnë nga Zona e cila përbëhet nga dy e më shumë vendbanime, fshatra apo lagje urbane- një mëditje për një Zonë.

Neni 11

Pas miratimi nga Kuvendi i Komunës, kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Shtojca 1.

Lista e 20 Zonave të përbërë nga Këshillat e qendrës urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në territorin e Komunës së Kaçanikut:

Nr.	Zonat	Këshillat e qendrës urbane, fshatrave dhe vendbanimeve
1.	Zona 1	Këshilli i qendrës urbane, zona I dhe;
2.	Zona 2	Këshilli i qendrës urbane, zona II;
3.	Zona 3	Fshati Bob;
4.	Zona 4	Fshati Dërnagllavë, Korbliq dhe Llanishtë;
5.	Zona 5	Fshati Runjevë dhe Stagovë;
6.	Zona 6	Fshati Kaçanik i Vjetër;
7.	Zona 7	Fshati Begracë;
8.	Zona 8	Fshati Doganaj dhe Koxhaj;
9.	Zona 9	Fshati Dubravë, Rekë dhe Vatë;
10.	Zona 10	Fshati Duraj dhe Gërlicë e Epërme;
11.	Zona 11	Fshati Elezaj dhe Gabrricë;
12.	Zona 12	Fshati Bajnicë dhe Semajë;
13.	Zona 13	Fshati Sllatinë dhe Soponicë;
14.	Zona 14	Fshati Kovaçec;
15.	Zona 15	Fshati Biçec;
16.	Zona 16	Fshati Nikaj;
17.	Zona 17	Fshati Gajre dhe Ivajë;
18.	Zona 18	Fshati Strazhë;
19.	Zona 19	Fshati Kotlinë dhe Gjurgjedell;
20.	Zona 20	Fshati Gllloboqicë;
		Vërejtje: Vija ndarëse ndërmjet zonave urbane është përroi i Rakocit.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-2476/20
Kaçanik, 31.01.2020

Në pajtim me nenin 12.2 (d) lidhur me nenin nenit 40.2 (j) të Ligjit Nr. 03/L-40 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), në zbatim të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 -Për Bashkëpunim Ndër Komunal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/10 Gusht 2011), Kuvendi i Komunës Kaçanik, me datë 31 Janar 2020, mori këtë:

VENDIM
PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL MË KOMUNËN E SHTËRPCËS

1. Me këtë Vendim, Miratohet Nisma e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal për realizimin e Projektit për rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës, nga fshati Sllatinë-Kaçanik deri në fshatin Brod –Shtërpcës.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunat si në vijim:
 - 2.1. Komuna e Kaçanikut; dhe
 - 2.2. Komuna e Shtërpcës.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Kaçanikut, për të filluar konsultimet me Komunën e Shtërpcës për përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal, për projektin e përcaktuar si në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në Ueb faqen e Komunës së Kaçanikut.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesët, Kryetari i Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Data	24.01.20	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	104/02-2476
		Shtojcë	/

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATË/A:	24. 01. 2020
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kuvendit Komunal Kemajl MËRSELI, kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM :	Besim ILAZI, kryetar i komunës
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	Nisma dhe Propozim-Vendimi për Miratimin e Nismës për bashkëpunim ndërkomunal me komunën e Shtërpçës

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese zyrtare ju dorëzojmë Nismën dhe Propozim-Vendimin për Miratimin e Nismës për bashkëpunim ndërkomunal me komunën e Shtërpçës.

Me qëllimi të hapjes së mundësisë për aplikim në fonde të Ministrisë së Pushtetit Lokal për projekte ndërkomunale, komunat duhet që paraprakisht të lidhin marrëveshje bashkëpunimi në mes tyre. Në suaza të kësaj komuna jonë në bashkëpunim me komunën e Shtërpçës janë dakorduar që të nisin negociata lidhur me rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës që lidhë dy fshatrat; Sllatinë të komunës së Kaçanikut dhe Brod të komunës së Shtërpçës që do të mundësonte një qasje shumë të favorshme në lëvizjen e qytetarëve që gravitojnë në këto zona dhe mundësimin e zhvillimit të turizmit në këtë zonë.

Të bashkëngjitur keni: Nismën për bashkëpunim dhe Propozim-Vendimin për miratimin e Nismës së bashkëpunimit

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik

Në pajtim me nenin 12, pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal, Kryetari i komunës së Kaçanikut propozon:

VENDIM

MBI BASHKËPUNIMIN NDËR KOMUNAL MË KOMUNËN E SHTËRPPCES

1. Me këtë Vendim miratohet nisma e kryetarit të komunës së Kaçanikut për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal për realizimin e propozim projektit për rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës nga fshati Sllatinë –Kaçanik deri në fshatin Brod-Shtërpçë.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunat si në vijim:
-Komuna e Kaçanikut dhe
-Komuna e Shtërpçes
3. Autorizohet kryetari i komunës për të filluar konsultimet me komunën e Shtërpçes për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen e komunës së Kaçanikut.

01/nr. 104/02-2476/2020
Komuna e Kaçanikut

Kryetari i komunës Kaçanikut

Besim ILAZO





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, **Kryetari i Komunës** paraqet kërkesë për miratimin:

NISMËN

PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E SHTËRPCËS NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE NË VISET RURALE

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave si në vijim:

- Komunës së Kaçanikut
- Komunës së Shtërpcës,

2. Bashkëpunimi ndërkomunal do të bëhet në fushën e infrastrukturës rrugore në territorin e Kaçanikut dhe Shtërpcës, ndërmjet zonave kadastrale të dy komunave sipas certifikatave të pronave dhe do të bëhet zgjerimi, rregullimi dhe lidhja e dy lokaliteteve, gjegjësisht fshatit Sllatinë dhe Brod.

Arsyetim

Me qëllim që të bëhet lidhja dhe qarkullimi i fshatrave nëpërmjet tyre, të dy komunat shprehin gatishmëri që të plotësohet infrastruktura rrugore nëpërmjet fshatrave Sllatinë dhe Brod.

Kjo do t'i mundësoj fshatrave një qasje shumë më të favorshme në pronat e tyre dhe krijimi i mundësive për zhvillim të turizmit në këtë zonë.

Me anë të këtyre marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkomunal mundësohet aplikimi me projekt propozim për realizim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

02/nr. 104/02-2476 /2020
Komuna e Kaçanikut
Datë: 24.01.2020





Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Këmajl Mërseli, Kryesues i kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emilija Redžepi, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 14.02.2020 Nr-VI-020-135
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut.	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.104/02-2476/20; për bashkëpunim ndër Komunal në Komunen e Shtërpçës

I miratuar më datë: 31.01.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.02.2020

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.